

# Pakoja Fiskale Emergjente Implikimet dhe sfidat e zbatimit

Qershor 2020







# **Pakoja Fiskale Emergjente**

# **Implikimet dhe**

# **sfidat e zbatimit**

**Qershor 2020**

**Financuar nga:**

Ky publikim është i financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS)  
dhe përgatitur nga Instituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest.

**Deklaratë mohimi:**

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të mbështetësve.

**Autor:**

Visar Vokrri

**Design:**

Envinion

Origjinali është shkruar në shqip.

**Publikuar nga:**

RIINVEST INSTITUTE

Lidhja e Prizrenit nr. 42

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

tel: + 381 (0)38 244320 | 38 223816

e-mail: [riinvest@riinvestinstitute.org](mailto:riinvest@riinvestinstitute.org)

[www.riinvestinstitute.org](http://www.riinvestinstitute.org)

**E drejta autoriale © 2020 nga INSTITUTI RIINVEST.**

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem riprodhimi, apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronik, apo mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi.



# HYRJE

Në pranverën e këtij viti Kosova ngjashëm si të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe pjesa dërmuese e Evropës, u detyrua të ndërmarrë masa restriktive në përpjekje për të mbajtur nën kontrollë situatën pandemike të shkaktuar nga COVID-19. Kufizimi i lëvizjes për qytetarët dhe pezullimi i aktivitetit biznesor në shumë sektorë shkaktoi rënie të ndjeshme të aktivitetit ekonomik në vend. Mund të themi që tashmë ka një konsensus të gjerë mes ekonomistëve sa i përket faktit që goditja (ang. shock) ekonomike nga pandemia është unike dhe si e tillë mund të jetë me pasoja të papara që nga koha e krizës së madhe ekonomike apo siç njihet Depresioni i Madh i viteve të 30-ta. Kjo goditje është ekzogjene, pra e shkaktuar nga faktorë të jashtëm, dhe rrjedhimisht nuk mund të themi që buron nga veprimet e pamatura dhe të pamenduara mirë të qeverive apo sektorit privat. Kjo në fakt e bënë këtë krizë të ndryshme nga kriza e fundit financiare e viteve 2007-2008. Kriza e shkaktuar nga gjendja pandemike do të manifestohet pak a shumë në të njëjtën mënyrë pothuajse në të gjitha vendet e prekura dhe konsiston në një miks kompleks të goditjeve si nga ana e kërkesës (konsumit) poashtu edhe nga ana e ofertës (bizneseve). Masat kufizuese kanë shkaktuar rënie drastike të kërkesës agregate dhe një lëksion që tashmë na e ka dhënë kriza e fundit e para më shumë se një dekadë është që pa një menaxhim të kërkesës agregate, dalja nga kriza apo rimëkëmbja do të jetë shumë më e ngadalshme. Kjo vjen në shprehje sidomos në vendet e mëdha eksportuese të cilat nuk mund të mbështeten në kërkesën e vendeve tjera (importuese) pasi që kjo krizë tashmë ka karakter global dhe eksportet gjithashtu do të afektohen në masë të madhe. Në kontekst të kërkesës problemi është i dyfishtë: (i) në njërin anë, rritja e papunësisë, largimi i përkohshëm nga puna, apo mungesa e aktivitetit të të vetëpunësuarve do të detyrojë ekonomitë familjare që të zvogëlojnë edhe më tej konsumin; (ii) në anën tjetër bizneset nuk kanë ndonjë arsye të investojnë në një periudhë krize kur kërkesa tashmë ka pësuar rënie.

Sa i përket ofertës, masat kufizuese të ndërmarra nga qeveritë për të parandaluar përhapjen e virusit, kanë imponuar një mori aktivitetesh të ndalojnë së ofruari shërbimet e tyre. Disa nga industritë apo aktivitetet më të prekura konsiderohen industria e argëtimit, industria e ndërtimit, industria e mikpritjes (ku hyjnë hotelieria, restorantet, e

**Kufizimi i lëvizjes për qytetarët dhe pezullimi i aktivitetit biznesor në shumë sektorë shkaktoi rënie të ndjeshme të aktivitetit ekonomik në vend. Mund të themi që tashmë ka një konsensus të gjerë mes ekonomistëve sa i përket faktit që goditja (ang. shock) ekonomike nga pandemia është unike dhe si e tillë mund të jetë me pasoja të papara që nga koha e krizës së madhe ekonomike apo siç njihet Depresioni i Madh i viteve të 30-ta.**

shërbime të ngjashme), apo edhe çdo aktivitet që është i varur nga turizmi. Një goditje shtesë nga aspekti i ofertës përfshirë edhe aktivitetet e lejuara gjatë kësaj kohe vjen edhe nga mbyllja e disa qyteteve/rajoneve të caktuara ku punëtorët e kishin të pamundur të lëviznin në baza ditore. Kjo pastaj kishte shkaktuar edhe mungesë të ofertës së atyre produkteve ku prodhimi i tyre është i varur nga një zinxhir kompleks i vlerës të cilat përfshijnë biznese që ishin jofunksionale në këtë kohë.

Parashikimet nga institucionet kryesore financiare ndërkombëtare për rritjen ekonomike globale këtë vit janë të zymta; sipas FMN këtë vit parashihet që rritja globale të jetë negative, më saktësisht rreth -3%. Gjithnjë sipas FMN, tkurrja ekonomike në Kosovë do të jetë rreth 5% nga një rritje prej 4% sa ishte parashikuar fillimisht. Pra, në terma nominal ekonomia e Kosovës do të jetë më vogël për rreth 600 milionë euro në raport me parashikimin për këtë vit. Mirëpo, cilat janë kanalet përmes të cilave do të manifestohet kjo rënie tek ne në Kosovë? As Kosova nuk bën ndonjë përjashtim sa i përket mënyrës së manifestimit. Rënia e kërkesës agregate do të përcillet me rënie të investimeve sidomos në industrinë përpunuese, sektorin e ndërtimit apo çdo aktivitet tjetër ekonomik që është i lidhur me turizmin. Rënia e aktivitetit ekonomik rrjedhimisht investimeve pashmangshmërisht do të ketë implikime edhe në punësim. Një numër i madh i vendeve të punës do të humben përkohësisht dhe pritjet të rikupërohen me lehtësimin e masave dhe hapjen e ekonomisë, mirëpo një numër jo i vogël do të humben në mënyrë permanente. Si pasojë e rënies së kërkesës do të ulet edhe importi dhe rrjedhimisht të hyrat tatimore të vjelura në importe (TVSH dhe tarifa doganore) si burime tejet të rëndësishme për mbushjen e buxhetit të Kosovës.

Implikime shtesë mund të ketë edhe nga rënia e dërgesave të diasporës apo remitencave ngase siç dihet një burim i qëndrueshëm i financimit të ekonomive familjare në Kosovë janë remitencat. Teoria, më konkretisht e ashtuquajtura hipoteza e zbutjes apo lehtësimit të gjendjes së pranuesve të remitencave, na mëson që remitencat kanë karakter kundër ciklik sa i përket të ardhurave në ekonominë ku remitencat luajnë rol të rëndësishëm në mirëqenien e ekonomive familjare. Nëse marrim për bazë këtë hipotezë dhe poashtu marrim të mirëqenë motivin altruistik të dërguesve mund të themi që remitencat do të vazhdojnë rrjedhën e tyre normale. Gjithashtu, nëse marrim për bazë fluksin e remitencave gjatë krizës 2007-2008, nuk pritjet që do të ketë rënie të ndjeshme të tyre. Në atë kohë pati rënie të tyre vetëm gjatë viteve 2010-2012 dhe

kjo rënie sillej prej rreth 3% mesatarisht në vit, të paktën pjesës që dërgohen përmes kanaleve zyrtare (banka apo institucione tjera të licencuara për transferimin e parave). Mirëpo, kontributi i diasporës në Ekonominë e Kosovës nuk mund të reduktohet vetëm në remitencë; ai është shumë më i madh se kaq. Paratë e shpenzuara dhe investimet e bëra gjatë pushimeve në Kosovë vlerësohen të jenë afërsisht sa niveli i remitencave. Andaj, efekti i diasporës do të vërehet në rast të mos hapjes së kufijve gjë e cila do të pamundësojë ardhjen e diasporës në Kosovë.

Pavarësisht efekteve fillestare, kohëzgjatja si dhe magnituda e kësaj krize do të varen nga efektshmëria e masave kufizuese dhe se sa shpejtë do të zhvillohet vakcina apo kura për shërimin e të prekurve nga virusi. Andaj, politika ekonomike dhe intervenimet përmes masave lehtësuese kanë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në ruajtjen e vendeve të punës si dhe zbutjen e pasojave socio-ekonomike.

# FAZA I E PAKOS NDIHMËSE – MASAT EMERGJENTE

Me fillimin e aplikimit të masave kufizuese me qëllim të parandalimit dhe ngadalësimit të përhapjes së virusit në vend, Qeveria e Kosovës përkatësisht Ministria e Financave dhe Transfereve (MFT) në bashkëpunim me ministrinë tjera të linjës si dhe shoqatat e bizneseve, përpiluan planin fillestar së bashku me pakon emergjente për ballafaqimin e goditjes së shkaktuar nga pandemia. Reagimi i Qeverisë ishte i menjëhershëm dhe u konsiderua si një hap i mirë

drejt lehtësimit të pasojave të krizës. Pakoja u aprovua më 3 Prill të këtij viti ndërsa shuma totale e kësaj pakoje ishte rreth 180 milionë Euro të shpërndara në 15 masa të ndryshme (Tabela 1). Meqenëse koha ishte e shkurtër dhe reagimi ishte i shpejtë, pothuajse që i pamundur një debat gjithëpërfshirës lidhur me masat. Gjithsesi, komuniteti i biznesit i përfaqësuar përmes shoqatave e asociacioneve të ndryshme ishte aktiv gjatë gjithë procesit.

TABELA 1. Pakoja Emergjente Fiskale

|                |                                                                                                                                                                                  |                     |
|----------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|
| <b>Masa 1</b>  | Pagesa e dyfishtë e vlerës së skemës sociale për të gjithë përfituesit e skemave sociale për muajin Prill dhe Maj                                                                | <b>€ 7,650,000</b>  |
| <b>Masa 2</b>  | Pagesa shtesë prej 30 Euro për të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale që marrin pagesë mujore me vlerë deri në 100 Euro                                          | <b>€ 13,000,000</b> |
| <b>Masa 3a</b> | Mbështetje financiare për bizneset në vështirësi financiare si pasojë e rënies së veprimtarisë së tyre për shkak të pandemisë: Pagat mujore të punëtorëve në vlerë prej 170 Euro | <b>€ 41,000,000</b> |
| <b>Masa 3b</b> | Mbështetje financiare për bizneset në vështirësi financiare si pasojë e rënies së veprimtarisë së tyre për shkak të pandemisë: Subvencionimi i qirasë                            | <b>€ 12,000,000</b> |
| <b>Masa 3c</b> | Mbështetje financiare për bizneset në vështirësi financiare si pasojë e rënies së veprimtarisë së tyre për shkak të pandemisë: Kontributet pensionale të punëtorëve              | <b>€ 8,000,000</b>  |
| <b>Masa 4</b>  | Huadhënie pa interes për Ndërmarrjet Publike në vështirësi financiare për shkak të pandemisë                                                                                     | <b>€ 20,000,000</b> |
| <b>Masa 5</b>  | Mbështetje financiare për komunat që janë ndikuar në përballje me pandeminë                                                                                                      | <b>€ 10,000,000</b> |
| <b>Masa 6</b>  | Sigurimi i shtesës mbi pagë në vlerë prej 300 Euro për punëtorët në terren dhe që janë drejtpërdrejtë të ekspozuar ndaj rrezikut të infektimit në punën e tyre                   | <b>€ 15,000,000</b> |




|                 |                                                                                                                                                                                                        |                      |
|-----------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| <b>Masa 7</b>   | Pagesë shtesë në vlerë prej 100 Euro për punëtorët e dyqaneve ushqimore, barnatoreve, furrave, për muajin Prill dhe Maj                                                                                | <b>€ 3,000,000</b>   |
| <b>Masa 8</b>   | Asistencë mujore në vlerë prej 130 Euro për qytetarët e Kosovës që humbin vendin e punës për shkak të situatës emergjente                                                                              | <b>€ 4,000,000</b>   |
| <b>Masa 9</b>   | Mbështetje për iniciativat që synojnë përmirësimin e jetës së komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës, që janë goditur më rëndë nga situata emergjente për shkak të pandemisë                  | <b>€ 2,000,000</b>   |
| <b>Masa 10a</b> | Sigurimi i likuiditetit financiar: Ndërmarrjet mikro dhe vetë-punësuarit nëpërmjet programeve të caktuara të Fondit për Garanci Kredituese                                                             | <b>€ 15,000,000</b>  |
| <b>Masa 10b</b> | Sigurimi i likuiditetit financiar: Bizneset e autorizuar që ofrojnë shërbime bazike të ngjashme me ato të ndërmarrjeve publike me kthim deri më 31.12.2020                                             |                      |
| <b>Masa 11</b>  | Rritje e buxhetit për grante dhe subvencione në bujqësi                                                                                                                                                | <b>€ 5,000,000</b>   |
| <b>Masa 12</b>  | Rritje e buxhetit për grante dhe subvencione Ministrisë së Kulturës                                                                                                                                    | <b>€ 5,000,000</b>   |
| <b>Masa 13</b>  | Mbështetje për eksportuesit                                                                                                                                                                            | <b>€ 10,000,000</b>  |
| <b>Masa 14</b>  | Mbështetje financiare për bizneset që regjistrojnë punëtorë me kontratë pune së paku një (1) vjeçare gjatë periudhës së situatës emergjente në vlerë prej 130 Euro për dy muaj pasues pas regjistrimit | <b>€ 6,000,000</b>   |
| <b>Masa 15</b>  | Pagesa e asistencës mujore në vlerë prej 130 Euro për qytetarët me kushte të rënda sociale të lajmëruar të papunë dhe që nuk janë përfitues të asnjë të hyre mujore nga buxheti i Kosovës              | <b>€ 3,000,000</b>   |
| <b>Totali</b>   |                                                                                                                                                                                                        | <b>€ 179,650,000</b> |

BURIMI: MINISTRIA E FINANCAVE DHE TRANSFEREVE TË KOSOVËS

Pakoja e aprovuar nga qeveria aso kohe kishte për qëllim parandalimin e përkeqësimit të gjendjes dhe lehtësimin e pasojave për grupet e prekura drejtpërdrejtë nga gjendja pandemike. Një gjë me rëndësi që duhet theksuar është fakti që në terma relativ pakoja me masat emergjente, me përjashtim të Serbisë, ishte më e madhja në rajon; kjo pako është ekuivalente me 2.5% të bruto produktit vendor (BPV) të Kosovës (Figura 1). Rreth 50% e vlerës së kësaj pakoje ishte e destinuar për përkrahje direkte financiare për sektorin privat duke përfshirë subvencionimin e një pjese të pagave, shpenzimet e qirasë, dhe kontributet

pensionale të punëtorëve. Pjesa tjetër e masave ishin të parapara për përfituesit e skemave sociale në Kosovë, komunitetet jo shumicë, si dhe grante dhe subvencione në bujqësi apo aktivitete kulturore. Masat përveç asistencës financiare kishin për qëllim edhe rritjen e punësimit formal. Një shumë prej 6 milionë eurosh ishte ndarë për bizneset të cilat regjistrojnë punëtorë të rregullt me kontratë pune të paktën një vjeçare. Gjithashtu, vlen të theksohet se njëra nga masat ishte e paraparë vetëm për bizneset eksportuese edhe pse nuk ishin bërë të qarta kushtet dhe mënyra e përfitimit nga kjo masë.

FIGURA 1: Pakoja emergjente në vendet e Ballkanit Perëndimor



BURIMI: FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR

Pavarësisht që vendimi për pakon emergjente ishte marrë qysh në fillim të muajit Prill, distribuimi i plotë i fondeve nga kjo pako nuk është bërë ende. Sipas deklaratave të deritanishme nga zyrtarët qeveritarë, përkatësisht Ministria e Financave dhe Transfereve, vetëm një e treta e buxhetit prej rreth 180 milionë eurosh është disbursuar deri më tani. Arsytet për vonesa të tilla duket të jenë kryesisht të natyrës burokratike. Me ligjin për buxhetin e vitit 2020, nuk ishin të parapara shpenzime të tilla, andaj në mungesë të fondeve të mjaftueshme emergjente duhet rishikuar buxheti dhe duhen bërë ndryshimet e nevojshme ligjore. Sipas përfaqësuesve të shoqatave të bizneseve në Kosovë, disa nga masat e pakos nuk kanë filluar të zbatohen fare përderisa pjesa tjetër e masave janë realizuar vetëm pjesërisht. Masa që ishte e paraparë të mbulonte deri në 50% të shpenzimeve të qirasë për muajt Prill dhe Maj për bizneset në vështirësi financiare (shih masa 3b) nuk është zbatuar deri më sot. Gjithashtu subvencionimi i pagave në vlerë prej 170 Euro të parapara për muajt Mars dhe Prill, është realizuar vetëm për një muaj pavarësisht që sipas vendimit ekzekutimi i pagesave do të duhej të bëhej në muajt Prill dhe Maj. Për më tepër, një numër jo i vogël i punëtorëve ende nuk kanë pranuar pagesat për muajin e parë. Mbi 30 mijë biznese dhe rreth 140 mijë punëtorë kishin bërë aplikimin për të

përfitur nga masat e parapara për kategori të ndryshme. Në njërën anë kapacitetet e limituara institucionale për t'u përballur me një fluks kaq të madh kërkesash ndërsa në anën tjetër aplikacionet jo të plota kishin vështirësuar tej mase administrimin e implementimit të masave. Ministri i Financave dhe Transfereve z. Besnik Bislimi në një prononcim kishte potencuar faktin që kishte pasur një numër jo të vogël të aplikimeve me gabime ndërsa në raste të caktuara kishte pasur edhe keqpërdorime nga ana e aplikuesve. Të gjitha këto sfida në një mënyrë apo tjetër kishin penguar implementimin e shpejtë të masave fiskale. Ndikim jo të vogël pati edhe kriza e fundit politike dhe ndryshimet pasuese në skenën politike të cilat pamundësuan ndryshimet buxhetore të domosdoshme për implementimin e plotë të pakos. Pra, pakja emergjente edhe pse ishte paraparë të shërbente si terapi për lehtësimin e gjendjes ajo pothuajse e humbi qëllimin e saj. Kjo ngase me fillimin e heqjes së masave restriktive dhe hapjen graduale të ekonomisë do të duhej të ishte implementuar në tërësi dhe kështu të fillonte së zbatuari një pako e re me masa më agresive për rimëkëmbjen ekonomike.

# PËRCEPTIMI I SEKTORIT PRIVAT MBI EFEKTET E PANDEMISË DHE MASAT EMERGJENTE

Me paraqitjen e rasteve të para të infektuarve në Kosovë dhe ndërmarrjen e menjëhershme të masave restriktive, pjesa dërmuese e sektorëve ekonomik kishin pezulluar aktivitetin e tyre. Të gjendur para një situatë të paprecedentë, sipas rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKSH), Qeveria e Kosovës krahas dizajnit të pakos emergjente, në koordinim me shoqatat e bizneseve përpiluan një plan dinamik të shtrirë në disa faza me zbatimin e masave restriktive. Pavarësisht numrit relativisht të vogël të rasteve të infektuara, dhe pasojave të paparashikueshme nga këto masa, reagimi i komunitetit të biznesit ishte në frymën e bashkëpunimit dhe solidarizimit me të gjitha institucionet shtetërore në ballafaqim me pandeminë. Gjatë fazës së parë të mbylljes dhe kufizimit të lëvizjes për qytetarët e Kosovës, përveç industrisë ushqimore, asaj farmaceutike si dhe sektorit të shitjes së mallrave ushqimore, pothuajse të gjitha aktivitetet tjera ishin paralizuar. Kjo bëri që efektet e para të goditjes ekonomike të ndiheshin menjëherë. Si rezultat i turrit të kërkesës agregate, pothuajse të gjithë sektorët ishin afektuar madje edhe një pjesë e atyre sektorëve të cilët ishin lejuar të operojnë gjatë gjithë kohës. Në bazë të rezultateve të anketës së realizuar nga shoqatat e bizneseve në muajin Prill, rreth 95% të bizneseve të anketuara kishin raportuar se kriza e shkaktuar nga pandemia kishte pasur efekt negativ.<sup>1</sup> Vlenë të theksohet se ky përceptim ishte i ngjashëm pothuajse në të gjithë sektorët ekonomik ndërsa kishte korrelacion pozitiv mes madhësisë së bizneseve dhe efektit që kriza kishte në to. Për më tepër, më shumë se gjysma e tyre kishin deklaruar se janë të shqetësuar për mbijetesën e tyre dhe kjo brengë është më e shprehur te ndërmarrjet e vogla dhe mikro; rreth 80% e bizneseve kishin raportuar rënie të shitjeve të tyre. Sa i përket punësimit, gati një e treta e bizneseve kishin deklaruar se qysh në javën e tretë të pandemisë numri

i punëtorëve të tyre ishte reduktuar. Gjithnjë sipas kësaj ankete, rreth 6% e bizneseve të intervistuar kishin larguar të gjithë punëtorët nga puna si pasojë e krizës. Shumica e bizneseve poashtu ishin shprehur se kanë qenë të kënaqur me qartësinë e vendimeve të qeverisë lidhur me masat kufizuese. Në anën tjetër, pakoja emergjente dhe masat e parapara në këtë pako ishin parë me skepticizëm nga sektori privat në Kosovë. Sipas tyre, masat më shumë kishin karakter social dhe si të tilla nuk mund të adresonin problemet akute të shkaktuara nga mbyllja e përkohshme e pjesës dërmuese të ekonomisë. Nga rezultatet e kësaj ankete shihet se vetëm një e katërta e bizneseve i kishin parë masat si lehtësuese përderisa pjesa tjetër nuk ishin të bindur. Gjetje të ngjashme ishin raportuar edhe në një studim tjetër të realizuar nga kompania e hulumtimeve Pyper.<sup>2</sup> Sipas të dhënave të këtij studimi, bizneset kishin vlerësuar kompensimin e pagave si masën më të dobishme të pakos emergjente ndërsa 95% e tyre kishin deklaruar se duhen masa shtesë në funksion të lehtësimit të pasojave nga pandemia. Gjithsesi, shumica e pagës së kompensuar prej 170 Euro, ekuivalente me pagën minimale në Kosovë, ishte përceptuar si shumë e ulët nga bizneset. Karakteri gjithëpërfshirës i masave kishte indinjuar një pjesë të bizneseve që nuk mund të ushtronin aktivitetin e tyre ngase jo të gjitha bizneset ishin prekur njësoj nga masat kufizuese. Pavarësisht kufizimeve buxhetore, komuniteti i biznesit pretendon që pakoja do të duhej të ishte diskriminuese duke pasur në fokus ato sektorë të cilët janë goditur më së tepërmi nga situata e krijuar. Andaj, duke parë që pritjet e tyre nuk ishin realizuar gjatë fazës emergjente si dhe duke parë vështirësitë gjatë implementimit të pakos fillestare, komuniteti i biznesit duhet të ketë rol aktiv dhe duhet të jetë mirë i përfaqësuar në diskutimin rreth masave për rimëkëmbjen ekonomike të vendit.

1 Mbledhja e të dhënave është bërë nga kompania Recura me iniciativë të shoqatave të bizneseve në Kosovë përfshirë Odën Ekonomike të Kosovës, Odën Ekonomike Amerikane, Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare, Këshillin e Investitorëve Evropian, si dhe Klubin e Prodhuesve të Kosovës.

2 Ky hulumtim është realizuar në bashkëpunim me Institutin Riinvest, Odën Ekonomike të Kosovës dhe Odën e Afarizmit të Kosovës. Të dhënat janë mbledhur nga 680 biznese anembanë Kosovës.

# PËRFUNDIME

Kufizimi i lëvizjes për qytetarët dhe pezullimi i aktivitetit biznesor në shumë sektorë shkaktoi rënie të ndjeshme të aktivitetit ekonomik në vend. Masat kufizuese shkaktojnë rënie drastike të kërkesës agregate. Qeveria e Kosovës në Mars të këtij viti aprovoi pakon fiskale emergjente me 15 masa si reagim për lehtësimin e pasojave të shkaktuara nga pandemia. Vlera totale e kësaj pakoje në terma nominal ishte 180 milionë euro apo rreth 2.5% e BPV të Kosovës. Në terma relativ, me përjashtim të Serbisë, pakoja e aprovuar ishte më e madhe se të gjitha vendet tjera të rajonit. Më shumë se gjysma e vlerës së kësaj pakoje ishte e paraparë për përkrahje direkte financiare për sektorin privat duke përfshirë këtu subvencionimin e pagave, një pjesë të shpenzimeve të qirasë si dhe kontributet pensionale të punëtorëve. Masat përveç asistencës financiare kishin për qëllim edhe rritjen e punësimit formal ku njëra nga masat ishte e paraparë për bizneset të cilat regjistrojnë punëtorë të rregullt me kontratë pune të paktën një vjeçare. Mbi 30 mijë biznese dhe rreth 140 mijë punëtorë kishin bërë aplikimin për të përfitur nga masat e parapara për kategori të ndryshme. Mirëpo, pavarësisht që vendimi për pakon emergjente ishte marrë qysh në fillim të muajit Prill, vetëm një e treta e fondeve nga pakoja emergjente është realizuar deri më tani. Masa që ishte e paraparë të mbulonte deri në 50% të shpenzimeve të qirasë për muajt Prill dhe Maj për bizneset në vështirësi financiare nuk ka filluar të zbatohet fare. Arsytet e vonësive përveç kapaciteteve të limituara institucionale si dhe procedurave burokratike janë edhe të natyrës fiskale por edhe politike. Me ligjin për buxhetin e vitit 2020, nuk ishin të parapara shpenzime të tilla, andaj në mungesë të fondeve të mjaftueshme emergjente fillimisht duhet rishikuar buxheti dhe gjithashtu duhen bërë ndryshimet e nevojshme ligjore. Kriza politike dhe ndryshimet në skenën politike gjithashtu vështirësuan zbatimin në tërësi të kësaj pakoje. Përveç vështirësive në implementimin e pakos emergjente, shumica e bizneseve nuk ishin të bindura në karakterin gjithëpërfshirës si dhe efektin e masave të kësaj pakoje ndërsa pakon në tërësi e konsideronin si të mangët. Kompensimi i pagave në vlerë prej 170 euro ishte parë si jo i mjaftueshëm. Pavarësisht nevojës

urgjente për reagim, pritjet e komunitetit të biznesit shpërfaqin mungesën e një koordinimi të mirëfilltë mes akterëve kyç gjatë fazës së përpilimit të pakos emergjente. Andaj, duke parë këto paqartësi gjatë implementimit të masave emergjente si dhe pakënaqësitë e komunitetit të biznesit gjatë kësaj periudhe, të paktën në fazën e rimëkëmbjes ekonomike të vendit është i nevojshëm një bashkëpunim më i ngushtë i të gjithë akterëve në dizajnimin e masave të reja për adresimin e nevojave të bizneseve.

